

Syllabusi i lëndës

Lënda: Koncepti i perceptimit të muslimanëve ndaj feve të tjera.

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4

Statusi i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 109

Fondi i orëve: 2+2

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: I

Mësimdhënësi: Prof. ass. dr. Zija Abdullahu, **e-maili:** zabdullai@hotmail.com

Përmbajtja e lëndës

Shkrimet religjioze dhe teologjia përfshinë, shkrimet më të rëndësishme në tri fetë me origjinë hyjnore, Hebraizmin, Krishterimin dhe Islamin. Si burimet e tyre, historikun e strukturimit, llojet, karakteristikat si interpretimin e tyre, si dhe formimin e teologjisë nga këto shkrime. Po ashtu përmban rezistencën e tyre ndaj shkencës, ndikimin në formimin e sekteve, rëndësinë e tyre në jetën e përditshme dhe dobinë e këtyre shkrimeve në bashkëjetesën e komuniteteve.

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kësaj lënde është që të përçojë sa më qartë te studenti historikun e këtyre shkrimeve, burimin, llojet dhe karakteristikat e tyre të përbashkëta dhe ato të ndryshme. Po ashtu t'i shpjegojë atij sa më hollësisht saktësinë e tyre nga këndvështrimi i brendshëm dhe ai i jashtëm, dhe mundësinë e ndërhyrjes apo jo të ndonjë autoriteti në këto shkrime. Me këtë studim synohet që studenti të vetëdijësohet për rëndësinë e këtyre shkrimeve në formimin e teologjisë në këto fe, si dhe formimin e sekteve të ndryshme brenda feve të lartpërmendura, dhe përdorimin e tyre në kultivimin e bashkëjetesës me komunitetet tjera. Gjithashtu synohet që studenti të jetë sa më i saktë në përcjelljen e kësaj njohurie të të tjerët, duke informuar dhe vetëdijësuar shoqërinë për rëndësinë e këtyre shkrimeve në jetën teologjike, si dhe në atë shoqërore e veçanërisht në ngritjen e tolerancës dhe harmonisë ndërshoqërore.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:

Të përshkruajë shkrime religjioze të secilës fe në vete

Të krahasojë këto shkrime ndërmjet njëra tjetrës qartazi

Të përshkruajë historikun e zhvillimit të këtyre shkrimeve dhe për rrjedhojë të zhvillimit teologjik

T'i dallojë shkrimet esenciale nga ato të dorës së dytë në secilën fe

T'i mbrojë qëndrimet e secilit shkrim ashtu siç e konceptojnë ithtarët e secilit religjion

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilit prej tyre, duke ia parashtruar argumentet përkatëse.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionet ndërfetare.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi.
Shqyrtime të përgjithshme: Definicioni i shkrimeve religjioze dhe teologjis

Literatura: France Farago, *“Krishterimi, Judaizmi, Islami, dhe mendimi perëndimor”*
përktheu: Bajram Muça, Lira, 1999, Tiranë. Ekrem Sarikçioğlu, *“Historia e feve*, përkth. Qani Nesimi, Logos-A, 2007 Shkup. (*Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë*).

Java e dytë: Pranimi apo refuzimi i shkrimeve ndër religjioze
Në Hebraizëm
Në Krishterim

Në Islam.

Bisedë interaktive mbi shkaqet e tanishme të përçarjes.

Literatura:

Java e tretë: Burimet e shkrimeve religjioze, sipas këndvështrimit të secilës në vete dhe atij të ndërsjellë.

Përsëritje nga orët e mëparshme

Literatura:

Java e katërt: Historia e strukturimit të shkrimeve religjioze.

Në Hebraizëm

Në Krishterim

Në Islam

Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura:

Java e pestë: Llojet e shkrimeve religjioze, në tre religjionet.

Debat rreth pasojave të luftërave ndër sektare në botën islame

Literatura:

Java e gjashtë: Karakteristikat e shkrimeve religjioze.

Karakteristikat e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet tyre

Literatura:

Java e shtatë: Saktësia e shkrimeve religjioze.

-Nga këndvështrimi i brendshëm

-Nga këndvështrimi i jashtëm

Testi i parë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit të parë

Literatura:

Java e tetë: Interpretimi i shkrimeve religjioze.

- Në Hebraizëm

- Në Krishterim

- Në Islam

Bisedë interaktive mbi marrëdhëniet shiite-sunite në kohën bashkëkohore.

Literatura:

Java e nëntë: Shkrimet religjioze dhe formimi teologjik.

Literatura:

Java e dhjetë: Shkrimet religjioze vetëm trashëgimi kulturore apo gjallëri shoqërore.

Literatura:

Java e njëmbëdhjetë: Shkrimet religjioze në ballafaqim me shkencën.
Debat mbi aktivitetin e Ahmedive në trojet tona.

Literatura:

Java e dymbëdhjetë: Ndikimi i shkrimeve religjioze në formimin e sekteve.
Diskutime dhe përsëritje të leksioneve nga ora e mëparshme.

Literatura:

Java e trembëdhjetë: Ndikimi i shkrimeve religjioze në përditshmërinë e individit dhe shoqëri.
Bisedë interaktive për shkaqet e përhapjes të këtyre shkollave në trojet tona.

Literatura:

Java e katërbëdhjetë: Mundësia e ndërhyrjes në shkrimet religjioze.
Debat rreth kontributit të tarikateve në trojet tona.

Literatura:

Java e pesëmbëdhjetë: Dobia e shkrimeve religjioze në kultivimin e bashkëjetesës midis komunitete.
Testi përfundimtarë, studentët ndahen në dy grupe dhe i nënshtrohen testit me shkrim.

Literatura:**Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%
Punimi seminarik 20%
Kollekfiumi i parë 30%
Kollekfiumi i dytë 30%
Vlerësimi në kontiunitet 10%
Total 100%

Literatura obliguese:

1. *Krishterimi, Judaizmi, Islami, dhe mendimi perëndimor*” përktheu: Bajram Muça, Lira, Tiranë, 1999,
2. Ekrem Sarikçioğlu, “*Historia e feve*, përkth. Qani Nesimi, Logos-A, Shkup, 2007.
3. Dr. Maurice Bucaille, *Bibla, Kur’ani, dhe shkenca*, përkth. Nazim Juniku, dhe Agim Jaka, Gjakovë 1997.

Literartura shtesë dhe bibliografia:

1. Dr. Zija Abdullau “*Studim Krahasimtarë i feve*”, Prishtinë, 2010
2. Ivan Cvitkovic, “*Religije suvremenoga svijeta*”, bot. III, Sarajev. 2005.
3. ----- “*Bazat e Biblës*”, Londër, pa v. bot.
4. ----- “*I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm*”, (pa autor), Watchtower Bible and Track Society of New York, Inc. Brokly, New York, U.S.A, 2007
4. Kukaj, Tahir, “*Besueshmëria e citateve Kur’anore dhe atyre Biblike*, Prishtinë, 2005.
5. Ehrman, Bart D., “*Të keqcitosh Jezusin*”, përktheu nga angl. Rezart Beka, Tiranë, 2007.
6. Xavier Leon –Dufour, “*Fjalor i teologjisë biblike*” përktheu: Odette Marquet, Napoli, 2009.